



27-03-2015

Të nderuar redaktorë,

Gjatë viteve të kaluara, ju keni pranuar komunikata për shtyp të EULEX-it rreth lëndëve në gjykata dhe prokurori ku kanë qenë të përfshirë gjyqtarët apo prokurorët e EULEX-it. Po ashtu, ju keni shqyrtuar me kujdes punën e EULEX-it duke i adresuar pyetje zyrës së EULEX-it për informimin e shtypit dhe publikut. Ne ju përgëzojmë për qasjen tuaj proaktive gjatë viteve të fundit duke i kërkuar llogari si EULEX-it ashtu edhe gjyqësorit të Kosovës.

Me Shkëmbimin e Letrave ndërmjet Presidentes së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, të ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës në prill të vitit 2014, gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it tani formalisht janë integruar në institucionet e Kosovës.

Misioni i EULEX-it, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës kanë rënë dakord se kjo epokë e re e partneritetit dhe vullneti i shprehur i autoriteteve të Kosovës për të marrë më shumë përgjegjësi, duhet gjithashtu të pasqyrohen edhe në komunikimin me publikun.

Kemi kënaqësinë që t'iu njoftojmë se tani e tutje institucionet e Kosovës do të jenë përgjegjëse për t'iu informuar juve dhe publikun e gjerë për aktivitetet e gjyqësorit të Kosovës. Gjykatat dhe prokuroritë tani kanë caktuar zyrtarët për shtyp, pikat e kontakteve të cilëve mund të gjenden në shtojcë. Ju lutemi që pyetjet rreth gjykatave dhe prokurorive t'i drejtoni drejtpërdrejt tek ata. Do të jetë përgjegjësi e tyre për të raportuar në mënyrë proaktive. EULEX-i do t'i ri-orientojë gazetarët, të cilët kërkojnë informacion mbi lëndët individuale në gjykata apo prokurori, tek institucionet përkatëse të Kosovës. Në mënyrë të ngjashme, EULEX-i do të lëshojë njoftime për shtyp vetëm në raste të jashtëzakonshme.

Ne shpresojmë që ju do të na shoqëroni në këtë përpjekje të re me të njëjtin qëndrim që keni treguar edhe në të kaluarën, duke mbështetur KGJK-në dhe KPK-në, si dhe gjykatat dhe prokuroritë në shtimin e përpjekjeve të tyre të komunikimit publik dhe të qenit të përgjegjshëm ndaj juve dhe publikut të gjerë.

EULEX-i do t'i ndihmojë institucionet e Kosovës në përpjekjet e tyre për informimin e publikut. EULEX-i do të vazhdojë të komunikojë me juve dhe publikun e gjerë, duke i shpjeguar aktivitetet dhe objektivat e Misionit. Megjithatë, një komunikim i tillë nuk do të hyjë më në hollësitë e lëndëve individuale të gjykatave apo të prokurorive. Gjithnjë e më shumë, ju do të shihni "më pak EULEX" dhe "më shumë Kosovë".


Gabriele Meucci

Shefi i Misionit të EULEX-it


Erver Peci

Kryesuesi i KGJK-së


Sylë Hoxhaj

Kryesuesi i KPK-së

Bashkëngjitur: detajet e kontaktit me zyrtarët e shtypit

KONTAKTET E GJYKATAVE

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Kryetar : Enver Peci

Web: www.kgjk-ks.org

Tel: 038 243 630

Zëdhënëse: Aishe Qorraj Berisha

Email: aishe.qorraj@rks-gov.net

Tel: +377 44 206 111

Gjykata Supreme e Kosovës

Kryetar: Fejzullah Hasani

Web: www.gjykatasupreme-ks.org

Zyra për shtyp: Antigona Uka

Email: antigona.uka@rks-gov.net

Tel: +377 44 247 706

Gjykata e Apelit

Kryetar: Salih Mekaj

Tel: 038 248 908

Press Office: Arber Jashari

Email: jashari.arber@gmail.com

Tel: +377 44 321 404

Gjykata Themelore e Prishtinës

Kryetar: Hamdi Ibrahim (044 163 145)

Email: hibrahimi57@hotmail.com

Tel: 038 243 806 / 038 248 248

Nuk ka zyrë për shtyp

Gjykata Themelore e Prizrenit

Kryetar: Ymer Hoxha

Tel: 029 223 773

Zyra për shtyp: Aferdita Kicaj

Email: Aferdita.kicaj@gmail.com

Tel: +377 44 729 316 ; +377 44 418 632

Gjykata Themelore e Pejës

Kryetar; Elmaze Syka

Tel: 039 433 725

Zyra për shtyp: Selvane Bukleta

Email: Selvane.bukleta@rks-gov.net

Tel: + 377 45 497 391

Gjykata Themelore e Gjakovës

Kryetar: Vaton Derguti

Web: www.gjykatat-ks.org/gjakove

Tel: 0390 324 130 NO Press Office

Gjykata Themelore e Mitrovicës

Kryetar: Kada Bunjaku

Web: www.gjykatat-ks.org/mitrovice

Zyra për shtyp: Bajramcurr Hasani

Email: bajramcurr.n.hasani@rks-gov.net

Tel: + 377 44 245 180

Gjykata Themelore e Gjilanit

Kryetar: Zyhdi Haziri

Web: www.gjykatat-ks.org/gjilan

Tel: 0280 322 180

Zyra për shtyp: Sabit Shkodra

Email: sabit.shkodra@rks-gov.net

Tel: +377 45 892 892

Gjykata Themelore e Ferizajt

Kryetar Bashkim Hyseni

Web: www.gjykatat-ks.org/ferizaj

Tel: 0290 321 009

Zyra për shtyp: Albenora Bekteshi

Tel: +377 45 303 426

Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK)

Zëdhënëse: Liridona Kozmaqi

Liridona.Kozmaqi@rks-psh.org

Tel: +381/38/200 18 766

Mob: +377/44/725-943

Prokuroria e Shtetit

Zyra për shtyp: Astrit Kolaj

astrit.kolaj@rks-psh.org; Mob: 045949596,

Hekrem Lutfiu

hekrem.lutfiu@rks-psh.org; Mob: 045317509